

Programi Përgatitor për Instruktor në Vendin e Punës

Bliterm, e licencuar nga **Autoriteti Kombëtar I Kualifikimeve të Kosovës**, ofron programin profesional për **Instruktor në Vendin e Punës**, një trajnim i specializuar që përgatit kandidatët për të planifikuar, organizuar dhe zhvilluar sesione trajnimi në vendin e punës. Ky program është dizajnuar për të ofruar njohuri të avancuara, aftësi praktike dhe kompetenca metodologjike, duke përmbushur standardet dhe kërkesat ligjore të Autoritetit Kombëtar të Kosovës për certifikimin e instruktorëve.

Qëllimi i Programit

Programi synon të pajisë kandidatët me aftësitë e nevojshme për të:

- Analizuar vendin e punës dhe përcaktuar nevojat për arsimin dhe aftësimin profesional;
- Identifikuar detyrat kryesore të punës dhe të nxjerrë proceset thelbësore të trajnimit;
- Përcaktuar rezultatet e mësimi/trajnimit sipas grupeve të synuara;
- Zgjedhur përmbajtjet, metodat dhe materialet më të përshtatshme për zhvillimin e trajnimit;
- Përzgjedhë dhe aranzhoj vendin e trajnimit;
- Zbatuar metodologji efektive të trajnimit dhe të monitorojë progresin e nxënësve/kandidatëve;
- Ofruar dhe pranuar feedback-in, si dhe të nxjerrë konkluzione për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit trajnues;
- Vlerësuar kompetencat dhe arritjet e kandidatëve në përputhje me standardet profesionale.

Pas përfundimit të trajnimit, kandidati do të ketë aftësi të plota për të organizuar dhe menaxhuar procesin e trajnimit në vendin e punës, duke kontribuar direkt në zhvillimin profesional të punonjësve dhe përmirësimin e cilësisë së procesit të punës.

Modulet e Trajnimit

Programi përbëhet nga katër module kryesore:

1. **Analiza dhe përcaktimi i detyrave të punës** – Identifikimi i nevojave të vendit të punës dhe grupit të synuar.
 2. **Organizimi dhe përgatitja e sesioneve të trajnimit** – Planifikimi i strukturës së trajnimit dhe përzgjedhja e metodave dhe materialeve.
 3. **Zhvillimi i trajnimit** – Implementimi i metodave praktike dhe të simuluar të mësimdhënies, monitorimi dhe asistenca gjatë sesioneve.
 4. **Vlerësimi i kandidatëve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i trajnimit** – Vlerësimi i performancës, dhënia e feedback-ut dhe nxjerrja e konkluzioneve për optimizimin e sesioneve të ardhshme.
-

Kriteret e Pjesëmarrjes

Për t'u regjistruar në këtë program, kandidati duhet të:

- Të jetë mbi 18 vjeç;
 - Të ketë përfunduar shkollimin e mesëm apo universitar.
-

Detajet e Trajnimit

- **Kohëzgjatja:** 80 orë mësimore;
 - **Certifikata:** lëshohet pas kalimit të testimit dhe ka **4 kredi të vlefshme**;
 - **Metodologjia e trajnimit:** përfshin ligjërata të strukturuar, diskutime, ushtrime praktike dhe simulime të situatave reale të punës si dhe testime modulare;
 - **Lokacioni:** Prishtinë;
 - **Orari:** 3 herë në javë.
-

APLIKO TANI: _____